

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 28 numër 1 prill 2026

Data e botimit: 22.4.2026

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 431, datë 19.1.2026, "Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarsë të agjentit në sigurime nga subjekti financiar jobankë "Tirana Factoring & Lease" sh.a." 4
2. Vendim i Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 526, datë 21.1.2026, "Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë "NOA" sh.a." 6
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 4, datë 25.3.2026, "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 7
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 25.3.2026, "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2025"" 9
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 25.3.2026, "Për dhënien e licencës bankës "Banka Jet" sh.a. në Republikën e Shqipërisë" 10
6. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2366, datë 25.3.2026, "Për miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme" 14
7. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2534, datë 31.3.2026, "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit" 15
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.8, datë 1.4.2026, "Për miratimin e "Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025"" 17
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarsë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë"" 18
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarsë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarsë nga subjektet financiare jobanka"" 22
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave"" 32
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 1.4.2026, "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarsë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre"" 38
13. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 13, datë 1.4.2026, "Për një ndryshim në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"" 42
14. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 14, datë 1.4.2026, "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 20 Lekë" 44
15. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 1.4.2026, "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 5000 Lekë" 46
16. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.16, datë 1.4.2026 "Për "Emërimin e Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë" 47



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË**

Nr. 431 prot.

Tiranë, më 19.1.2026.

VENDIM

Nr. 431, datë 19.1.2026.

PËR

**DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARSË TË
AGJENTIT NË SIGURIME NGA SUBJEKTI FINANCIAR JOBANKË "TIRANA
FACTORING & LEASE" SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 16 pika 1, nenit 17, pika 1, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, dhe të shtojcës nr. 3, pika 19, të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, pasi u njoha me kërkesën e subjektit financiar jobankë "TIRANA FACTORING & LEASE" sh.a., dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSA:

1. Miratimin paraparak për subjektin financiar jobankë "TIRANA FACTORING & LEASE" sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë të agjentit në sigurime.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet subjekti financiar jobankë "TIRANA FACTORING & LEASE" sh.a. të paraqesë një kopje të licencës pranë Bankës së Shqipërisë, pas miratimit të saj nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË

NATASHA AHMETAJ



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË**

Nr. 526 prot.

Tiranë, më 21.1.2026

VENDIM
Nr. 526, datë 21.1.2026

**PËR
REVOKIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË "NOA" SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 14, pika 1, shkronja "j" dhe nenit 15 të rregullores "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka" miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; të pikës 16 të shtojcës nr. 3 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 61, datë 5.11.2025, "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. me subjektin financiar jobankë NOA sh.a.", dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSA:

1. Të revokoj licencën nr. 9, datë 6.6.2007 të subjektit financiar jobankë "NOA" sh.a., të përditësuar me nr. 9/1, datë 1.3.2022 dhe të ankesit të saj.
2. Shoqëria "NOA" sh.a. duhet të dorëzojë pranë Bankës së Shqipërisë licencën dhe aneksin e saj.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË

NATASHA AHMETAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 4, datë 25.3.2026

“PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 5, datë 25.3.2026

PËR
MIRATIMIN E "PASQYRAVE FINANCIARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR
VITIN 2025"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "l", dhe të nenit 69, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2025", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Pasqyrat financiare të miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe opinionit i audituesit të jashtëm, janë pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2025.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Politikës Monetare.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 7, datë 25.03.2026

PËR
DHËNIEN E LICENCËS BANKËS "BANKA JET" SH.A. NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të neneve 14, 20, 21 dhe 54 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 2 të Shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare bankës "Banka Jet" sh.a. në Republikën e Shqipërisë.
2. Të miratojë kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare për "Bankën Jet" sh.a., sipas Shtojcës 1 bashkëlidhur të këtij vendimi.
3. Ngarkohet "Banka Jet" sh.a. që të njoftojë me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave për datën e fillimit të veprimtarisë.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Operacioneve Monetare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohet Guvernatori me nënshkrimin e licencës të bankës “Banka Jet” sh.a. dhe aneksit të veprimtarive bashkëlidhur licencës.
6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

SHTOJCA 1

Mbi veprimtaritë bankare dhe financiare, sipas përcaktimit të nenit 4 dhe nenit 54, pika 2, të ligjit për bankat, për të cilat licençohet dhe lejohet të ushtrojë veprimtari "Banka Jet" sh.a.:

- a. Pranimi i depozitave në para dhe i fondeve të ripagëshme nga publiku;
- b. Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe hipotekare;
- c. Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike.;
- d. Shërbimet e pagesave duke përfshirë:
 - i. Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
 - ii. Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
 - iii. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
 - ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
 - ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
 - ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike,
 - iv. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
 - ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
 - ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
 - ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
 - v. Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave,
 - vi. Dërgesat e parave,
 - vii. Shërbimi i inicimit të pagesës,
 - viii. Shërbimi i informimit të llogarisë;

- e. Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutash, në një treg të vetëorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i. Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj.),
 - ii. Këmbim valutash.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI**

Nr. 2366 Prot

Tiranë më 25.3.2026

VENDIM
Nr. 2366 datë 25.3.2026

**PËR
"MIRATIMIN E POLITIKËS SË ADMINISTRIMIT TË MJETEVE FINANCIARE TË
FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME"**

Në bazë të nenit 73, paragrafi 1, të ligjit nr.133/2016 "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", nenit 15, të rregullores nr. 56, datë 03.10.2017 "Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij", e ndryshuar, nenit 53 pika 4 të ligjit 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe nenit 11, pika 6 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, me propozim të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar politikën e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2026.
2. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe Departamenti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATORI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 2534 prot.

Tiranë, më 31.03.2026

VENDIM
Nr.2534, datë 31.03.2026

PËR
CAKTIMIN E SHITESAVE MAKROPRUDENCIALE TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12, 14 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "ç" dhe "d", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë mbetet 0.5 për qind, dhe do të përmbushet duke filluar nga data 31 mars 2027.
2. Bankat me rëndësi sistemike (BARS) dhe shtesat përkatëse të kapitalit (SIST), përcaktohen si me poshtë:

BARS	Vlerësimi për SIST-in total	SIST-i për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2027
Banka Kombëtare Tregtare sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Credins sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Raiffeisen sh.a.	1.0 për qind	1.0 për qind
Banka Intesa SanPaolo Albania sh.a.	0.5 për qind	0.5 për qind

3. Shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, zbatohen së bashku me shtesën konservuese të kapitalit (KONS) sipas tabelës 2, të nenit 10, pika 1, të rregullores 41/2019, ku vlera e KONS-it në vijimësi është në nivelin 2.5 për qind.

4. Shtesat makroprudenciale të kapitalit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, zbatohen dhe mbahen në nivel institucioni të veçantë (solo basis).
5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
6. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 8, datë 1.4.2026

**PËR
MIRATIMIN E "RAPORTIT TË STABILITETIT FINANCIAR PËR
GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2025**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "ç", dhe nenit 69, paragrafi 6, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmuja të dytë të vitit 2025", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin dhe dërgimin e këtij raporti në Kuvendin e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave dhe në institucionet e tjera përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 9, datë 1.4.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE
DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në bazë dhe për zbatim të nenit të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreut II të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 4, pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“3. Për qëllime të kësaj rregulloreje, person me “reputacion të mirë” konsiderohet aksionari dhe administratori i bankës, i cili karakterizohet nga etika profesionale dhe integriteti moral dhe financiar, si dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor e rregullativ. Një aksionar apo administrator do të konsiderohet të ketë reputacion të mirë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

 - a) nuk është i akuzuar në një proces penal;
 - b) nuk është i dënuar penalisht;
 - c) nuk ka detyrime pasurore dhe tatimore të pashlyera;
 - d) nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm; dhe
 - e) nuk bën pjesë në listat e shpallura të sanksioneve ndërkombëtare.”;

- b) Në nenin 5, pika 2, pas togfjalëshit "të noterizuar", shtohet togfjalëshi "/legalizuar";
- c) Në nenin 7, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja "c", pas nënpikës "ix", shtohet nënpika "ix/1" me përmbajtjen e mëposhtme:
"ix/1. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë,";
 - ii. në pikën 1, shkronja "c", nënpika "xi", pas togfjalëshit "• deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (formulari 15)", shtohet togfjalëshi i mëposhtëm:
"• vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë,";
 - iii. në pikën 1, shkronja "c", nënpika "xii", pas togfjalëshit "• deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (formulari 15)", shtohet togfjalëshi i mëposhtëm:
"• vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë,";
 - iv. në pikën 1, shkronja "d", pas nënpikës "x", shtohet nënpika "xi" me përmbajtjen e mëposhtme:
"xi. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë,";
- d) Në nenin 8, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 4, përmbajtja e shkronjës "n" ndryshon si më poshtë:
"n. në rastin e degës ose filialit të bankës së huaj, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me bankën mëmë, lidhur me dërgimin nga kjo e fundit të informacionit periodik për gjendjen financiare të bankës së huaj, si dhe informacionin e nevojshëm për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (PPP/FT), për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar. Në kuadër të mbikëqyrjes së konsoliduar, banka mëmë vë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, informacion të plotë, të dokumentuar dhe të përditësuar lidhur me politikat dhe masat e brendshme efektive të zbatuara në nivel grupi, në fushën e PPP/FT, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të mbikëqyrjes financiare.";
 - ii. në pikën 5, përmbajtja e shkronjës "c" ndryshon si më poshtë:
"c. skemës së mbikëqyrjes bankare në vendin e origjinës, nëse banka e huaj (mëmë) e degës së bankës i nënshtrohet mbikëqyrjes efektive në vendin e saj, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe aftësinë e autoritetit mbikëqyrës bankar të këtij vendi për të përmbushur këtë funksion;";

- iii. në pikën 6, pas togfjalëshit "për parandalimin e pastrimit të parave," , shtohet togfjalëshi "Agjencia e Inteligjencës Financiare,";
- iv. pas pikës 6, shtohet pika 6/1 me përmbajtjen e mëposhtme:
"6/1. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriteve të përshtatshmërisë dhe integritetit të aksionarëve dhe administratorëve të bankës, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Bashkimit Evropian (BE), njoftimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe listat e integruara të personave të shpallur.";
- v. në pikën 7, togfjalëshi "Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave", zëvendësohet me togfjalëshin "Agjencia e Inteligjencës Financiare";
- e) Në nenin 9, pika 2/1 pas shkronjës "e", shtohen shkronjat "f" dhe "g" me përmbajtjen e mëposhtme:
*"f. aksionarët e bankës nuk kanë reputacion të mirë;
g. aksionarët e bankës kanë qenë pjesë e strukturës së pronësisë së një banke apo institucioni financiar, ndaj të cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet tjetër mbikëqyrës.";*
- f) Në nenin 11, pika 1, në fund të shkronjës "a" shtohet fjalia e mëposhtme:
"Në çdo rast, nëse gjatë procesit të licencimit nuk plotësohet kundërvlera në lekë si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë kërkon plotësimin e shumës së bllokuar të kapitalit, të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;"
- g) Në nenin 17, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 4, pas togfjalëshit "për parandalimin e pastrimit të parave," , shtohet togfjalëshi "Agjencia e Inteligjencës Financiare,";
- ii. në pikën 6, përmbajtja e shkronjës "d", ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:
"d) aksionarët e propozuar të bankës paraqesin rrezik të lartë dhe/ose nuk gëzojnë reputacion të mirë.";
- iii. pas pikës 6, shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:
"7. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratim për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim nuk plotësohet nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën. Banka ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së miratimit paraprak, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";
- h) Në nenin 19, pas pikës 5, shtohen pikat 6 dhe 7 me përmbajtjen e mëposhtme:
"6. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për njoftimet e parashikuara në këtë nen, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së paraqitjes së këtij njoftimi. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën. Banka ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të njoftimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";

7. Banka e Shqipërisë, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e vlerëson të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.”;

- i) Në nenin 24/2, pika 1, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “c” me përmbajtjen e mëposhtme:
“c) ekstraktin e regjistrimit tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në të cilin të jetë përcaktuar qartë ushtrimi i veprimtarisë si agjent i bankës, duke specifikuar gjithashtu emrin e plotë të bankës.”;
 - j) Në formularin nr. 5, pas togfjalëshit “Emri i aksionarit” shtohet togfjalëshi “(deri në përfituesin e fundit)”;
 - k) Në formularin nr. 12, togfjalëshi “SEKRET” zëvendësohet kudo me togfjalëshin “KONFIDENCIAL”;
 - l) Në formularin nr. 15, pas togfjalëshit “kur aksionari i propozuar”, shtohet togfjalëshi “/përfituesi i fundit individ”, pas togfjalëshit “lidhur me aksionarin e propozuar”, shtohet togfjalëshi “/përfituesin e fundit individ” dhe pas togfjalëshit “i aksionarit të propozuar”, shtohet togfjalëshi “/përfituesit të fundit individ”, si dhe në fund të formularit shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
“Shënim: Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.”.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 10, datë 1.4.2026

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR LICENCIMIN, USHTRIMIN E VEPRIMTARISË, REVOKIMIN E LICENCËS
DHE LIKUIDIMIN E PORTOFOLIT TË KREDIVE TË KRIJUAR NGA USHTRIMI I
VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 1, datë 17.1.2013, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 4, pika 2, pas shkronjës “o”, shtohet shkronja “p” me përmbajtjen e mëposhtme:

“p) “pronar përfitues” - ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues.”;
 - b) Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. në pikën 1, shkronja “f”, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“f) për këmbimin valutor5,000,000 (pesë milionë) lekë”;
 - ii. pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me përmbajtjen e mëposhtme,

"5/1. Subjektet që kërkojnë të kryejnë vetëm veprimtarinë e këmbimit valutor, plotësojnë kushtet e parashikuara në rregulloren "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor" dhe licencohen si zyra të këmbimit valutor."

- iii. në pikën 6, togfjalëshi "Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal, çdo shtesë e mëvonshme e tij si dhe çdo ndryshim në strukturën e kapitalit", zëvendësohet me togfjalëshin "Çdo pagesë e kapitalit fillestar minimal dhe çdo shtesë e mëvonshme e tij",
- iv. në pikën 7/1, togfjalëshi "aksionerët/ortakët e propozuar", zëvendësohet kudo me togfjalëshin "aksionerët/ortakët dhe pronarët përfitues," dhe togfjalëshi "Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave", zëvendësohet me togfjalëshin "Agjencia e Inteligjencës Financiare";

c) Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. në pikën 2, shkronja "f", togfjalëshi "themeluesit/aksionerët/ortakët dhe/ose përfaqësuesin ligjor:", zëvendësohet me togfjalëshin "themeluesit/aksionerët/ortakët dhe përfaqësuesin ligjor (nëse është e aplikueshme):",
- ii. në pikën 2, pas shkronjës "f", shtohet shkronja "f/1" me përmbajtjen e mëposhtme:
"f/1) vërtetimi ose raporti i kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent i lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;"
- iii. në pikën 2, shkronja "g", pas togfjalëshit "për kapitalin", shtohet fjala "fillestar",
- iv. në pikën 2, shkronja "g", nënpika "ii", paragrafi "për personat juridikë:", pas togfjalëshit "blerjen e aksioneve", shtohet togfjalëshi "/kuotave" dhe togfjalëshi "certifikata e autoriteteve kompetente që siguron të dhëna", zëvendësohet me togfjalëshin "dokumente të lëshuara nga autoritetet kompetente që sigurojnë të dhëna",
- v. në pikën 2, shkronja "g", nënpika "iii", togfjalëshi "paragrafët 1, 2, 3 ose 4", zëvendësohet me togfjalëshin "paragrafët 1, 2, 3 ose 5," dhe në fund të nënpikës "iii", shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
"Në çdo rast, nëse gjatë procesit të licencimit nuk plotësohet kundërvlera në lekë si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë kërkon plotësimin e shumës së bllokuar të kapitalit, të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;"
- vi. në pikën 2, shkronja "h", pas nënpikës "v", shtohen nënpikat "vi", "vii" dhe "viii", me përmbajtjet e mëposhtme:
"vi. strukturën e kapitalit të aksionarëve/ortakëve dhe pronarëve përfitues të subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë (sipas formularëve përkatës nr. 12, nr. 13 dhe nr. 14 të kësaj rregulloreje). Në informacionin sipas kësaj shkronje duhet të deklarohet nëse kjo strukturë përmban ose jo aksione të mbajtësit (bearer shares), ose aksionarë përfaqësues (nominee shareholders);
vii. listën e pjesëmarrjeve të tërthorta në kapitalin e subjektit, në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind, të shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:

- dokumentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si person juridik dhe statutin e shoqërisë,
- dokumentacionin përkatës se nuk ka detyrime fiskale të prapambetura për t'u paguar për periudhën më të fundit,
- deklaratën noteriale për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve,
- vërtetime, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:
 - nuk është i akuzuar në një proces penal (kur është e aplikueshme),
 - personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme),
 - personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,
 - ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paaftësisë pague, të falimentimit ose të likuidimit, etj.

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

- vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë,
- deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 11 të kësaj rregulloreje);

viii. listën e pronarëve përfitues në kapitalin e subjektit, në një vlerë jo më të vogël se 5 për qind, të shoqëruar me informacionin e mëposhtëm:

- kopje të noterizuar/legalizuar të dokumentit të identifikimit,
- informacione për lidhje familjare me aksionerët/ortakët e subjektit,
- dokumentacionin ligjor përkatës se nuk ka detyrime fiskale të prapambetura për t'u paguar për periudhën më të fundit,
- deklaratë për shlyerjen e rregullt të detyrimeve ndaj të tretëve (në qoftë se ka),
- vërtetime të lëshuara nga organet kompetente se:
 - nuk është i akuzuar në një proces penal,
 - personi nuk ka qenë dënuar ndonjëherë penalisht,
 - personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.

- vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë,
- deklaratën e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 11 të kësaj rregulloreje);",

vii. në pikën 2, shkronja "i", kudo pas paragrafit me përmbajtjen: "• deklaratën, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 11, të kësaj rregulloreje);", shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

"• vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;"

- viii. në pikën 2, shkronja "j", ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:
- "j) dokumentacioni për kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin dhe kryetarin e komitetit të kontrollit, siç parashikohet në nenin 9/1 të kësaj rregulloreje;";
- d) Në nenin 9/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, pas shkronjës "j", shtohet shkronja "k" me përmbajtjen e mëposhtme:
 - "k) vërtetimi ose raporti i kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent i lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.",
 - ii. pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen e mëposhtme:
 - "2/1. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj do të kryhet në dy faza, si më poshtë:
 - a) në fazën e parë, Banka e Shqipërisë shpreh moskundërshtimin e saj për emërimin e administratorit shtetas të huaj kur, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij neni, krijon bindjen se përmbushen kriteret e përcaktuara në këtë pikë.
 - b) në fazën e dytë, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak për emërimin e administratorit shtetas të huaj, pas plotësimit të dokumentacionit në përputhje me pikën 2 të këtij neni.",
 - iii. në pikën 4, togfjalëshi "sipas pikave 1 deri 3 të këtij neni", zëvendësohet me togfjalëshin "sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni";
- e) Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja "a", togfjalëshi "aksionarët/ortakët e subjektit", zëvendësohet me togfjalëshin "aksionarët/ortakët/pronarët përfitues të subjektit",
 - ii. pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:
 - "1/1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, person me "reputacion të mirë" konsiderohet aksionari/ortaku, pronari përfitues, administratori dhe anëtari i organit drejtues të subjektit, i cili karakterizohet nga etika profesionale dhe integriteti moral dhe financiar, si dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor e rregullativ. Një aksionar/ortak, pronar përfitues, administrator apo anëtar i organit drejtues do të konsiderohet të ketë reputacion të mirë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:
 - a) nuk është i akuzuar në një proces penal;
 - b) nuk është i dënuar penalisht;
 - c) nuk ka detyrime pasurore dhe tatimore të pashlyera;
 - d) nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm; dhe
 - e) nuk bën pjesë në listat e shpallura të sanksioneve ndërkombëtare.",
 - iii. në pikën 2, shkronja "c", pas togfjalëshit "me pjesëmarrje influencuese", shtohet togfjalëshi "dhe pronarëve përfitues",
 - iv. në pikën 2, shkronja "d", pas togfjalëshit "aksionarët/ortakët", shtohet togfjalëshi "/pronarët përfitues",
 - v. në pikën 2, shkronja "d", pas nënpikës "vii", shtohen nënpikat "viii" dhe "ix" me përmbajtjet e mëposhtme:
 - "viii. nuk ka reputacion të mirë;
 - ix. ka qenë pjesë e strukturës së pronësisë së një institucioni financiar, ndaj të

cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet tjetër mbikëqyrës;

- vi. *në pikën 3, pas togfjalëshit "për parandalimin e pastrimit të parave", shtohet togfjalëshi "Agjencia e Inteligjencës Financiare",*
- vii. *pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me përmbajtjen e mëposhtme:
"3/1. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të aksionerëve/ortakëve, pronarëve përfitues, administratorit dhe anëtarëve të organeve drejtuese të subjektit, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Bashkimit Evropian (BE), njoftimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe listat e integruara të personave të shpallur.";*
- f) *Në nenin 11, në fund të pikës 4, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
"Subjekti ka të drejtë të riaplikojë për licencim, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";*
- g) *Përmbajtja e nenit 14 ndryshon si më poshtë:*

"Neni 14 Pezullimi dhe revokimi i licencës

1. *Banka e Shqipërisë mund të pezullojë licencën e subjektit financiar jobankë ose të institucionit financiar të mikrokredisë, në rast se:*
 - a) *kërkohet nga vetë subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, i licencuar;*
 - b) *ndaj aksionarit/ortakut ose vetë subjektit fillon kryerja e hetimeve ose regjistrohet procedimi penal, për vepra penale që lidhen me veprimtarinë e subjektit ose për vepra të tjera penale, deri në dhënien e vendimit për mosfillimin e procedimit, vendimit për pushimin e akuzës ose të çështjes, ose vendimit përfundimtar të gjykatës për shpalljen të pafajshëm apo fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet;*
 - c) *konstatohen shkelje të parashikuara në nenin 35 të rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka".*
2. *Banka e Shqipërisë revokon licencën e subjektit financiar jobankë ose të institucionit financiar të mikrokredisë, në rast se:*
 - a) *kërkohet nga vetë subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, i licencuar;*
 - b) *ekzistojnë të dhëna të besueshme se aksionerët/ortakët/pronarët përfitues ose administratorët apo vetë subjekti, janë përfshirë në aktivitete të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;*
 - c) *licenca është siguruar në bazë të informacionit jo të vërtetë, pavarësisht nëse është dhënë nga subjekti apo ka të bëjë me subjektin, duke përfshirë të dhënat për kualifikimet, përvojën ose reputacionin e administratorëve dhe të aksionerëve/ortakëve me pjesëmarrje influencuese dhe pronarëve përfitues, ose parregullsi të tjera për fakte të rëndësishme që lidhen me shqyrtimin e kërkesës për licencë;*
 - d) *nuk përmbush më kushtet në bazë të të cilave ai është licencuar;*
 - e) *subjekti nuk fillon veprimtarinë brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja e licencës ose ndërpret ushtrimin e veprimtarisë për më shumë se 3 (tre) muaj;*
 - f) *subjekti ka pushuar së ekzistuari si person juridik;*
 - g) *konstatohen shkelje të parashikuara në nenin 35 të rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka".*

3. Vendimi për pezullimin ose revokimin e licencës duhet të përmbajë arsyet përkatëse dhe i komunikohet menjëherë me shkrim, subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë.
 4. Vendimi i pezullimit ose revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
 5. Subjekti ndaj të cilit është marrë masa e pezullimit apo revokimit, ndalohet të kryejë veprimtaritë e parashikuara në licencën e tij, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë, për pezullimin e licencës (gjatë kohëzgjatjes së pezullimit) apo për revokimin e saj.
 6. Subjekti ndaj të cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë, nuk mund të aplikojë sërish për licencim.”;
- h) Në nenin 16 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja “d”, togfjalëshi “të transferojë pronësinë e një ortaku ose aksionari me pjesëmarrje influencuese”, zëvendësohet me togfjalëshin “të ndryshojë nëpërmjet blerjes, shitjes ose transferimit, pjesëmarrjen influencuese (të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë)”;
 - ii. në fund të pikës 3, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
“Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.”;
- i) Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja “c” ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:
“c) për ndryshimin nëpërmjet blerjes, shitjes ose transferimit të pjesëmarrjes influencuese (të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë) ose kontrollit të subjektit:
- në rastet e pjesëmarrjes influencuese të drejtpërdrejtë:
 - i. vendimin e asamblesë për miratimin e këtij ndryshimi;
 - ii. dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, paragrafi 2, shkronjat “f”, “g”, “h” dhe “i” të kësaj rregulloreje;
 - iii. kopje të aktmarrëveshjes së nënshkruar për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese ose kontrollit të subjektit;
 - iv. planin e biznesit sipas kërkesave të nenit 8, paragrafi 2, shkronja “k” të kësaj rregulloreje, kur kërkohet transferimi i pjesëmarrjes influencuese, që tejkalon nivelin 50 për qind të kapitalit të subjektit ose të të drejtave të votës, në rastet kur kanë ndodhur/pritet të ndodhin ndryshime të mundshme në modelin e biznesit;
 - v. në rastin dhe kur si pasojë e ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese, në kapitalin e subjektit përfshihet një aksionar/ortak i ri, ky i fundit duhet të paraqesë deklaratën noteriale me të cilën ai angazhohet se do të ruajë interesat e klientëve të subjektit;
 - në rastet e pjesëmarrjes influencuese të tërthortë:
 - i. vendimin e asamblesë për miratimin e këtij ndryshimi;
 - ii. dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, paragrafi 2, shkronjat “f”, “g”, “h” dhe “i” të kësaj rregulloreje;
 - iii. kopje të aktmarrëveshjes së nënshkruar për ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese ose kontrollit të subjektit;”;

- ii. në pikën 3, pas togfjalëshit "për parandalimin e pastrimit të parave", shtohet togfjalëshi "Agjencia e Inteligjencës Financiare,";
- iii. pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtjet e mëposhtme:
 - 4. Banka e Shqipërisë gjatë vlerësimit sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, zbaton edhe përcaktimet e pikës 7/1 të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
 - 5. Banka e Shqipërisë jep miratimin ose refuzon ndryshimin e pjesëmarrjes influencuese të subjektit, jo më vonë se tre (3) muaj nga data kur dokumentacioni sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, është paraqitur i plotë.";
- j) Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. në pikën 4, shkronja "d", togfjalëshi "sipas përcaktimit të shkronjës "g" të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;" zëvendësohet me togfjalëshin "sipas përcaktimit të nenit 8, pika 2, shkronja "g", nënpika "ii" të kësaj rregulloreje;"
 - ii. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"4/1. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për njoftimet e parashikuara në këtë nen, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga subjekti brenda 6 (gjashhtë) muajve pas datës së paraqitjes së këtij njoftimi. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim subjektin. Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të njoftimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";
- k) Në nenin 30/1, pika 4, pas togfjalëshit "aksionarët/ortakët", shtohet togfjalëshi ", pronarët përfitues";
- l) Pas nenit 31, shtohet neni 31/1, me përmbajtjen e mëposhtme:

"Neni 31/1

Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional

- 1. Administratorët dhe të punësuarit e subjektit, autoritetet gjyqësore, si dhe inspektorët apo nëpunësit e tjerë të Bankës së Shqipërisë ose të autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse të huaja, për çdo informacion që marrin gjatë ushtrimit të veprimtarisë në subjekt, ruajnë sekretin dhe nuk e përdorin atë për përfitime vetjake ose për të tretët jashtë subjektit, të cilëve u shërbejnë ose u kanë shërbyer.
 - 2. Informacioni i përshkruar në pikën 1 të këtij neni, mund t'i jepet vetëm Bankës së Shqipërisë, ekspertit kontabël të autorizuar të subjektit, administratorëve, nëpunësve të çdo sistemi informacioni ose shërbimi zyrtar të parashikuar në nenin 23 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", autoriteteve juridike që e fitojnë këtë të drejtë me ligj, si dhe kur e kërkon mbrojtja e interesave të subjektit në procedurat ligjore.";
- m) Në formularin nr. 11 (aneksi i rregullores), pas togfjalëshit "aksionari/ortaku", shtohet togfjalëshi "/pronari përfitues", pas togfjalëshit "aksionarin/ortakun", shtohet togfjalëshi "/pronarin përfitues", pas togfjalëshit "aksionar/ortak", shtohet togfjalëshi "/pronar përfitues" dhe pas togfjalëshit "aksionerit/ ortakut", shtohet togfjalëshi "/pronarit përfitues", si dhe në fund të formularit shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
"Shënim: Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika

10, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij."/;

- n) Pas formularit nr. 11, shtohen formularët nr. 12, nr. 13 dhe nr. 14, sipas përmbajtjes në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

FORMULARI NR. 13

Lista e aksionarëve/ortakëve të subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë

Aksionarë/ortakë të drejtpërdrejtë	Numri i aksioneve/kuotave	Përqindja e aksioneve/kuotave	Vlera e aksioneve/kuotave

Shënim: Vazhdon në rreshta të tjerë, në qoftë se është e nevojshme.

FORMULARI NR. 14

Struktura e aksionarëve/ortakëve të subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë

Nr.	Emri i aksionarit/ortakut/pronarit përfitues	Numri i aksioneve/kuotave	Vlera e aksioneve/kuotave (në lekë)	Pjesëmarrja direkte në kapitalin e subjektit (në përqindje)	Pjesëmarrja indirekte në kapitalin e subjektit (në përqindje)	Totali i pjesëmarrjes (në përqindje)
1						
2						
3						

Në informacionin sipas formularit nr. 14, duhet të deklarohet nëse struktura e aksionerëve/ortakëve të subjektit financiar jobankë ose institucionit financiar të mikrokredisë përmban apo jo aksione të përmendura në shkronjat "l" dhe "m" të pikës 2 të nenit 4 të kësaj rregulloreje.

Shënim: Vazhdon në rreshta të tjerë, në qoftë se është e nevojshme."



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 11, datë 1.4.2026

**PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE DHE INSTITUCIONEVE
TË PARASË ELEKTRONIKE, SI DHE PËR REGJISTRIMIN E OFRUESVE TË
SHËRBIMEVE TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”; nenit 4, pika 46, dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të neneve 4, 7, 8, 9, 13, 14, 15, 21, 28 dhe 31 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”; nenit 194, pika 4, të ligjit nr. 52/2014, datë 22.5.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 24.11.2021, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - i. në pikën 2, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “e” me përmbajtjen e mëposhtme:
“e) “pronar përfitues” - ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues.”;

- ii. pas pikës 3 shtohet pika 4, me përmbajtjen e mëposhtme:
- "4. Për qëllime të kësaj rregulloreje, person me "reputacion të mirë" konsiderohet aksionari/ortaku, pronari përfitues, administratori dhe anëtari i organit drejtues të subjektit, i cili karakterizohet nga etika profesionale dhe integriteti moral dhe financiar, si dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor e rregullativ. Një aksionar/ortak, pronar përfitues, administrator apo anëtar i organit drejtues do të konsiderohet të ketë reputacion të mirë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:*
- a) *nuk është i akuzuar në një proces penal;*
 - b) *nuk është i dënuar penalisht;*
 - c) *nuk ka detyrime pasurore dhe tatimore të pashlyera;*
 - d) *nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm;*
 - e) *nuk bën pjesë në listat e shpallura të sanksioneve ndërkombëtare."*
- b) Në nenin 5, pika 6, togfjalëshi "aksionarët/ortakët e propozuar", zëvendësohet kudo me togfjalëshin "aksionarët/ortakët dhe pronarët përfitues" dhe togfjalëshi "Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave", zëvendësohet me togfjalëshin "Agjencia e Inteligjencës Financiare";
- c) Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 2, shkronja "a", pas togfjalëshit "nga themeluesit", shtohet togfjalëshi " , aksionarët/ortakët";
 - ii. në pikën 2, shkronja "b", pas fjalës "themeluesve", shtohet togfjalëshi " , aksionarëve/ortakëve";
 - iii. në pikën 2, shkronja "c", pas togfjalëshit "nga themeluesit", shtohet togfjalëshi " , aksionarët/ortakët/pronarët përfitues";
 - iv. në pikën 2, shkronja "c", pas nënpikës "vii", shtohen nënpikat "viii" dhe "ix" me përmbajtjet e mëposhtme:
 - "viii. nuk ka reputacion të mirë;*
 - ix. ka qenë pjesë e strukturës së pronësisë së një institucioni financiar, ndaj të cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet tjetër mbikëqyrës."*
 - v. në pikën 4, pas togfjalëshit "pastrimit të parave," , shtohet togfjalëshi "Agjencia e Inteligjencës Financiare,";
 - vi. pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

"5. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të aksionarëve/ortakëve, pronarëve përfitues, administratorit dhe anëtarëve të organeve drejtuese, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Bashkimit Evropian (BE), njoftimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe listat e integruara të personave të shpallur."
- d) Në nenin 8, në fund të pikës 4, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
"Subjekti ka të drejtë të riaplikojë për licencim, duke paraqitur dokumentacionin përkatës."

- e) Në nenin 11, pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:
"5. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike ndaj të cilit është vendosur masa e shfuqizimit të licencës nga Banka e Shqipërisë, nuk mund të aplikojë sërish për licencim.";
- f) Në nenin 17, në fund të pikës 1, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
"Në çdo rast, nëse gjatë procesit të licencimit nuk plotësohet kundërvlera në lekë si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë kërkon plotësimin e shumës së bllokuar të kapitalit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.";
- g) Në nenin 26, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja "b", pas togfjalëshit "aksionarëve/ortakëve", shtohet togfjalëshi "dhe pronarëve përfitues";
 - ii. në pikën 1, shkronja "b", nënpika "ii", pas togfjalëshit "dhe arsyes e këtij kualifikimi", shtohet togfjalëshi " , si dhe pronarët përfitues";
 - iii. në pikën 3, shkronja "i", pas togfjalëshit "strukturën e aksionarëve", shtohet togfjalëshi "/ortakëve/pronarëve përfitues", si dhe hiqet togfjalëshi " , sipas përcaktimit në nenin 17, pika 1, shkronja "f" të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë";
 - iv. në pikën 5, shkronja "b", nënpika "i", pas togfjalëshit "blerjen e aksioneve", shtohet togfjalëshi "ose kuotave", dhe togfjalëshi "certifikatën e autoriteteve kompetente që siguron", zëvendësohet me togfjalëshin "dokumente të lëshuara nga autoritetet kompetente që sigurojnë";
- h) Në nenin 30, pika 1, pas shkronjës "b", shtohet shkronja "c" me përmbajtjen e mëposhtme:
"c) ekstraktin e regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), në të cilin të jetë përcaktuar qartë ushtrimi i veprimtarisë si agjent i institucionit të pagesës, duke specifikuar gjithashtu emrin e plotë të institucionit përkatës.";
- i) Në nenin 36, në fund të pikës 1, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
"Në çdo rast, nëse gjatë procesit të licencimit nuk plotësohet kundërvlera në lekë si pasojë e luhatjeve të kursit të këmbimit, Banka e Shqipërisë kërkon plotësimin e shumës së bllokuar të kapitalit, të përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.";
- j) Në nenin 45, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja "b", pas togfjalëshit "aksionarëve/ortakëve", shtohet togfjalëshi "dhe pronarëve përfitues";
 - ii. në pikën 1, shkronja "b", nënpika "ii", pas togfjalëshit "dhe arsyes e këtij kualifikimi", shtohet togfjalëshi " , si dhe pronarët përfitues";
 - iii. në pikën 3, shkronja "i", pas togfjalëshit "strukturën e aksionarëve", shtohet togfjalëshi "/ortakëve/pronarëve përfitues", si dhe hiqet togfjalëshi " , sipas përcaktimit në ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit";

- iv. në pikën 5, shkronja "b", nënpika "i", pas togfjalëshit "blerjen e aksioneve", shtohet togfjalëshi "ose kuotave", dhe togfjalëshi "certifikatën e autoriteteve kompetente që siguron", zëvendësohet me togfjalëshin "dokumente të lëshuara nga autoritetet kompetente që sigurojnë";
- k) Në nenin 50, në fund të pikës 8, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
"Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për regjistrim, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";
- l) Në nenin 64, në fund të pikës 4, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
"Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";
- m) Në nenin 67, pika 1, pas shkronjës "k", shtohet shkronja "l" me përmbajtjen e mëposhtme:
"l. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.";
- n) Në nenin 70, pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:
"2. Në rastin kur subjekti kërkon të ushtrojë veprimtari/shërbime shtesë, të parashikuara në pikat 4 dhe/ose 5 të Aneksit nr. 1 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", ai paraqet kërkesën dhe dokumentacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, si dhe në rastet kur subjekti parashikon edhe të japë kredi të lidhura me këto shërbime shtesë, njofton Bankën e Shqipërisë për këtë dhe për kufirin maksimal deri në të cilin do të japë kredi lidhur me shërbimet e pagesave.";
- o) Në nenin 72 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 2, shkronja "l", pas togfjalëshit "të ligjit "Për shërbimet e pagesave"", shtohet togfjalëshi ", përfshirë një përshkrim të llojit dhe volumit të parashikuar të veprimtarive;";
- ii. pas pikës 2, shtohen pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 me përmbajtjen e mëposhtme:
"2/1. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike, në rastin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) vendimin e asamblesë së aksionarëve/ortakëve për zmadhimin e kapitalit;
b) relacionin shoqërues për rritjen e kapitalit;
c) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit, përkatësisht të pikës 5 të nenit 26 ose të pikës 5 të nenit 45 të kësaj rregulloreje.
- 2/2. Institucioni i pagesave dhe institucioni i parasë elektronike, në rastin e ndryshimeve në strukturën e kapitalit, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:*
- a) aktin për veprimin juridik përkatës, që sjell më pas ndryshimet në strukturën e kapitalit;

- b) vendimin e organit drejtues të shoqërisë për dhënien e pëlqimit për kalimin e pronësisë të aksioneve/kuotave (nëse është e aplikueshme);
- c) relacionin shoqërues për ndryshimet në strukturën e kapitalit;
- d) deklaratën noteriale të aksionarëve/ortakëve përfitues lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit përkatësish të pikës 5, shkronja "b" të nenit 26 ose të pikës 5, shkronja "b" të nenit 45 të kësaj rregulloreje;
- e) vërtetime, për aksionarët/ortakët përfitues, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:
- i. nuk është i akuzuar në një proces penal (kur është e aplikueshme),
 - iii. personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme),
 - iv. personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,
 - v. ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paaftësisë pague, të falimentimit ose të likuidimit etj. (kur është e aplikueshme).
- Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së njoftimit në Bankën e Shqipërisë.
- f) deklaratën e aksionarit/ortakut përfitues, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje).
- g) vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive për aksionarin/ortakun, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.
- 2/3. Banka e Shqipërisë, nëse e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.";
- p) Në formularët nr. 5 dhe nr. 6 (aneksi i rregullores), në shënimin në fund të formularëve, pas fjalës "themelues", shtohet togfjalëshi "/ aksionar/ortak";
- q) Në formularin nr. 7 (aneksi i rregullores), pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:
- "5. Informacion mbi hapësira/mjedise të veçanta të nevojshme, si dhe kushte të përshtatshme për evidentimin, mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me ushtrimin e veprimtarisë.";
- r) Në formularin nr. 9 (aneksi i rregullores), pas togfjalëshit "aksionari / ortaku", shtohet togfjalëshi "/pronari përfitues", pas togfjalëshit "aksionarin/ortakun", shtohet togfjalëshi "/pronarin përfitues", pas togfjalëshit "aksionar / ortak", shtohet togfjalëshi "/ pronar përfitues", pas togfjalëshit "aksionarit / ortakut", shtohet togfjalëshi "/ pronarit përfitues", si dhe në fund të formularit shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
- "Shënim: Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.";
- s) Në formularin nr. 10 (aneksi i rregullores), në fund të formularit

shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.”;

- t) Në formularin nr. 11 (aneksi i rregullores), fjala “SEKRET” zëvendësohet kudo me fjalën “KONFIDENCIAL”.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 12, datë 1.4.2026

**PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
"PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË
KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit të nenit 12, shkronja "a", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 69, pika 6, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"; dhe të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 4, pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtjen mëposhtme:

"3. Për qëllime të kësaj rregulloreje, person me "reputacion të mirë" konsiderohet anëtari, donatori, administratori dhe anëtari i organit drejtues të SHKK-së ose të unionit, i cili karakterizohet nga etika profesionale dhe integriteti moral dhe financiar, si dhe përputhshmëria me kuadrin ligjor e rregullativ. Një anëtar, donator, administrator apo anëtar i organit drejtues do të konsiderohet të ketë reputacion të mirë, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

 - *nuk është i akuzuar në një proces penal;*
 - *nuk është i dënuar penalisht;*
 - *nuk ka detyrime pasurore dhe tatimore të pashlyera;*
 - *nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm; dhe*
 - *nuk bën pjesë në listat e shpallura të sanksioneve ndërkombëtare."*

- b) Në nenin 5, pika 9/1, togfjalëshi "Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave", zëvendësohet me togfjalëshin "Agjencia e Inteligjencës Financiare";
- c) Në nenin 6, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 2, shkronja "f", pas nënpikës "iii", shtohet nënpika "iv" me përmbajtjen e mëposhtme:
"iv. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;"
 - ii. në pikën 2, shkronja "g", pas nënpikës "iii", shtohet nënpika "iv" me përmbajtjen e mëposhtme:
"iv. vërtetimin ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj, i cili të jetë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë;"
- d) Në nenin 7, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në fund të pikës 3, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
"SHKK-ja ka të drejtë të riaplikojë për licencim, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";
 - ii. në pikën 4/1, pas togfjalëshit "për parandalimin e pastrimit të parave,", shtohet togfjalëshi "Agjencia e Inteligjencës Financiare,";
 - iii. pas pikës 4/1, shtohet pika 4/2 me përmbajtjen e mëposhtme:
"4/2. Banka e Shqipërisë, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshatshmërisë dhe integritetit të anëtarëve themelues/donatorëve, administratorit dhe anëtarëve të organeve drejtuese, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Bashkimit Evropian (BE), njoftimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si dhe listat e integruara të personave të shpallur.";
- e) Në nenin 8, pika 1/1, shkronja "b", pas nënpikës "iv", shtohen nënpikat "v" dhe "vi", me përmbajtjet e mëposhtme:
- "v. nuk ka reputacion të mirë;*
vi. ka qenë pjesë e strukturës së pronësisë së një institucioni financiar, ndaj të cilit është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë ose nga një autoritet tjetër mbikëqyrës.";
- f) Në nenin 12, pas pikës 6, shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:
"7. SHKK-ja ndaj së cilës është vendosur masa e revokimit të licencës nga Banka e Shqipërisë, nuk mund të aplikojë sërish për licencim.";
- g) Në nenin 14, pika 1, pas shkronjës "h", shtohet shkronja "i" me përmbajtjen e mëposhtme:
"i) vërtetim ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent nga organet kompetente të shtetit të huaj, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.";
- h) Në nenin 16, në fund të pikës 3, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

"SHKK-ja ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";

- i) Në nenin 18, pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4 me përmbajtjet e mëposhtme:
- "3. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për njoftimet e parashikuara në këtë nen, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga SHKK-ja brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së paraqitjes së këtij njoftimi. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim SHKK-në. SHKK-ja ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të njoftimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.*
- 4. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, nëse e vlerëson të nevojshme, përveç sa është parashikuar në këtë nen.";*
- j) Në nenin 22, në fund të pikës 4, shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:
- "Subjekti ka të drejtë të kërkojë rifillimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.";*
- k) Në nenin 24, pika 2, pas shkronjës "h", shtohet shkronja "i" me përmbajtjen e mëposhtme:
- "i) vërtetim ose raportin e kredimarrësit nga regjistri i kredive, ose një dokument ekuivalent nga organet kompetente të shtetit të huaj, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë.";*
- l) Në formularin nr. 6 (aneksi i rregullores), pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:
- "5. Informacion mbi hapësira/mjedise të veçanta të nevojshme, si dhe kushte të përshtatshme për evidentimin, mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me ushtrimin e veprimtarisë.";*
- m) Në formularin nr. 10 (aneksi i rregullores), në fund të formularit, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
- "Shënim: Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.";*
- n) Në formularin nr. 10/1 (aneksi i rregullores), në fund të formularit, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:
- "Shënim: Për qëllime të plotësimit të këtij formulari, lidhje familjare me një person do të konsiderohen të afërmit e ngushtë sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 10 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ku përfshihen: a) fëmijët (ose të birësuarit); b) fëmijët e fëmijëve; c) bashkëshorti/ja; d) prindërit; e) vëllezërit, motrat, si dhe fëmijët e tyre; f) personat në kujdestarinë e tij.";*

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 13, datë 1.4.2026

**PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN
"PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 9 dhe nenit 126, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 60, pika 1 dhe nenit 66 të ligjit nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"; të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar; dhe të ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", miratuar me vendimin nr.44, datë 10.6.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:
 - a) Në nenin 6, pas pikës 16, shtohet pika 17 me përmbajtjen e mëposhtme:
"17. Politikat, rregullat dhe procedurat e brendshme të hartuara nga subjektet për administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje, miratohen nga organet drejtuese përkatëse të subjekteve."
2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin

e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 14, datë 1.4.2026

**PËR
RISHTYPJEN E MONEDHAVE METALIKE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME
PRERJE 20 LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronja "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16 të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 133, datë 7.12.2016, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor me prerje 20 Lekë, në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e monedhave metalike, të jetë viti 2026.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të aneksit, që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 15, datë 1.4.2026

**PËR
RISHTYPJEN E KARTËMONEDHAVE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME
PRERJE 5000 LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33 pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39 pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16, të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 7.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor me prerje 5000 Lekë në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e kartëmonedhave, të jetë viti 2017.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të aneksit, që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 16, datë 1.4.2026

**PËR
“EMËRIMIN E ZËVENDËSGUVERNATORIT TË PARË TË BANKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me propozim të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të emërojë zj. Holta Zaçaj në detyrën e Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO

